



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Kryetarja

Nr. 3552 Prot.

Tiranë, më 17.11.2023

URDHËR
Nr. 63 datë 17.11.2023

PËR MBLEDHJEN E KUVENDIT NË SEANCË PLENARE, DATË 20.11.2023, ORA 10.00

Në mbështetje të nenit 7, pika 6, nenit 27/1, nenit 82 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në kalendarin e punimeve të Kuvendit për shqyrtimin e paketës fiskale dhe projektbuxhetit për vitin 2024,

URDHËROJ:

- I. Mbledhjen e Kuvendit në seancën plenare të datës 20.11.2023, ora 10:00.
II. Rendi i ditës i seancës plenare është si më poshtë:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 9.11.2023.
2. Njoftime.
3. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë””, të ndryshuar”.
(*Shqyrtimi në parim*)
4. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. (*Shqyrtimi në parim*)
5. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”.
(*Shqyrtimi në parim*)
6. Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. (*Shqyrtimi në parim*)
7. Projektligji “Për buxhetin e vitit 2024”. (*Shqyrtimi në parim*)
8. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.

III. Ngarkohen Shërbimet e Kuvendit për publikimin e rendit të ditës të seancës plenare, njoftimin e anëtarëve të Kuvendit me anë të mjeteve të komunikimit elektronik si dhe përgatitjen e dokumentacionit parlamentar që do të shqyrtohet.

IV. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARJA
Lindita NIKOLLA





SEANCË PLENARE PUBLIKE

E hënë, 20 nëntor 2023, ora 10.00

RENDI I DITËS

Në mbështetje të urdhrin nr. 63, datë 17.11.2023 të Kryetares së Kuvendit, znj. Lindita Nikolla, rendi i ditës është si më poshtë vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 9.11.2023.

(Neni 44, pika 2 e Rregullores)

2. Njoftime.

(Neni 44, pika 3 e Rregullores)

3. Projektligj “Për disa ndryshime në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë””, të ndryshuar”.

4. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë””, të ndryshuar”.

5. Projektligj “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”.

6. Projektligj “Për disa shtesa në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë””, të ndryshuar”.

7. Projektligj “Për buxhetin e vitit 2024”.

(Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 dhe 158, të Kushtetutës, të nenit 30, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 55, 73-74, 78-82 të Rregullores së Kuvendit, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare)

Koha e votimit në parim

8. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.

(Në mbështetje të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit: Çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta dhe nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta. Koha e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta)